



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

C.nr.369/2018

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË, si kontestimore e përberë nga Gjyqtari individual Ragip Kadriu, ne çështjen juridike te paditësit **RSH** nga M te cilin sipas autorizimit me shkrim e përfaqëson B Q nga M, kundër te paditurës Komuna e M- Drejtoria, për shkak te kompensimit te ardhurave ne emër te shpërblimit jubilar dhe kompensimin te pagave përcjellëse për ne pension pas mbajtjes se seancës kryesore, me dt. me dt.05.06.2019 bie këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET si e bazuar kërkesëpadia e paditësit RSH nga M dhe, **OBLIGOHET** e paditura Komuna e M t'ia paguajë paditësit RSH nga M, në emër te pagesës për shpërblim jubilar pas pensionimit si mësimdhënës te e paditura për 41 të përvojës se punës ne vlerë te 150% te një page bazë, shumen prej 706.63 € dhe ne emër te 3 pagave përcjellëse për ne pension, shumën prej 1,413.27 €, respektivisht shuma totale prej 2,119.90 €, te gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e marrjes së aktgjykimit nën kërcënim të përmbarimit te detyrueshëm.

II.OBLIGOHET e paditura Komuna e M Arsimit t'ia paguajnë paditësit shpenzimet e procedurës në shumë prej 269 €, të gjitha në afat prej 7 ditësh nga dita e marrjes së aktgjykimit nën kërcënim të përmbarimit te detyrueshëm.

A r s y e t i m

Paditësi përmes te autorizuarit te tij me datën 29.05.2018 ka ushtruar padi e për kompensimin e te ardhurave personale pas pensionimit dhe atë ne emër te 150% te një page bazë dhe te 3 pagave përcjellëse me rastin e pensionimit në shumën e përgjithshme prej 2,119.90 €.

Gjykata, me dt. 19.03.2019, ka caktuar seancë për shqyrtim kryesor, në të cilën ka prezantuar i autorizuari i paditësit dhe përfaqësuesi i të paditurës.

I autorizuari i paditësit në seancë te shqyrtimit gjyqësor kryesor dhe në fjalën përfundimtare deklaroi se mbetem pran padis se parashtruar me propozim si në referatin e propozuar, ndërsa hjeku dorë sa i përket pagesës së kamatës.

I autorizuari i të paditurës në seancën e shqyrtimit kryesor deklaroi, se e kundërshton padinë dhe kërkesëpadinë duke pasur parasysh mungesën e mjeteve financiare të cilat kanë munguar në vitin 2017, por nuk është kontestuese që paditësi ka qenë punëtor i DKA-së.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, lidhur me çështjen konkrete juridike, referuar nenit 7 dhe 8 te LPK-së, gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit kryesor-publik nxori dhe administroi këto prova: Kontrata e Punës e datës 07.12.2009, Vendimi i Ministris së i datës, Aktvendimi mbi marrëdhënien e punës e lëshuar nga shkolla ” e datës, Kërkesa për pagesën e tri rrogave mesatare si dhe të shpërblimit jubilar e datës, Qarkullimi i llogarisë bankare në emër të paditësit pranë PB e datës dhe pas shqyrtimit bashkërisht gjitha këtyre provave gjykata konstatoi këtë gjendje:

Fillimisht paditësi para ngritjes se padis ju ka drejtuar te paditurës me kërkesë te dt. për kompensimin e tri rrogave mesatare si dhe të shpërblimit jubilar, ndërsa ne shkresat e lëndës nuk ka dëshmi qe e paditura i ka kthyer përgjigje.

Nuk është kontestues fakti qe paditësi ka qene në marrëdhënie pune te e paditura si mësimdhënës 41 vite, ky fakt u vërtetua nga Aktvendimi i Shkollës Fillore në M nr i datës, ne emër te paditësit.

Nuk është kontestues fakti se me vendimin Vendimet e lëshuar nga MPMS-Departamenti i Pensioneve te dt. paditësi është shfrytëzues i pensionit kontributiv ne shumë prej 186 €, që nga data e pensionimit.

Nuk është kontestues fakti se lartësia e pagës neto qe paditësi e ka realizuar nga e paditura para pensionimit është shuma mujore prej 471.09 € ku kjo vërtetohet nga gjendja e llogarisë e datës për periudhën 01.01.2017 deri me .

Gjykata, lidhur me bazën e kërkesë padisë, iu referua nenit 35 par. 8 nën par 8.4 të Kontratës Kolektive të Arsimit te dt.18.04.2017 e cila parasheh se “punëtorët të cilët dalin në pension përfitojnë shpërblim jubilar për 40 vjet të përvojës në vlerë të 150% te një page bazë” dhe nenit 35.9 të po të njëjtës kontratë i cili parasheh se “punëtorët të cilët dalin në pension përfitojnë pagesë përcjellëse në lartësi të tri (3) pagave, sipas mesatares se tri pagave të fundit të punëtorit”, mirëpo duke marr parasysh faktin se paditësi me rastin e daljes ne pension, e paditura ia ka paguar një pagë përcjellëse, gjykata e obligoj te paditurën qe paditësit ti paguaj 3 paga përcjellëse.

Gjykata, lidhur me lartësinë e kërkesëpadisë, u referua në vlerën e tri pagave të fundit të paditësit e cila vërtetohet në bazë të pasqyrës bankare të dt. 03.04.2018, se paditësi ka marre tri pagat e fundit ne vlere prej 471.09 €.

Prandaj, gjykata bazuar ne nenit 35 par. 8 nën par. 8.4 dhe nenit 35 par 9 të Kontratës Kolektive të Arsimit të dt.18.04.2017 vendosi për kompensimin e shumës së përgjithshme prej 2,119.90 € dhe atë në emër të tri pagave përcjellëse shumën prej 1,413.27 € dhe në emër të shpërblimit jubilar(150% të një page bazë) shumën prej 706.63 €.

Vendimin që pala e paditur t'i bartë shpenzimet e procedurës kontestimore, gjykata e ka mbështetur në dispozitat ligjore konform nenit 449 dhe 452 të Ligjit për Procedurën Kontestimore. Lartësia e shpenzimeve të aprovuara, i referohet shpenzimeve të përfaqësuesit të autorizuar të paditëses, për 1 seancë të mbajtur, në shumën prej 135 euro, 104 euro ne emër te përpilimit te padis dhe 30 euro ne emër te taksës për padi.

Gjykata aktgjykimin e saj e bazoi në nenin 143 par 1 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË

C.nr.369/2018 data 05.06.2019

GJYQTARI
Ragip Kadriu

UDHEZIM MBI MJETIN JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi, lejohet e drejta në ankesë, në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të të njëjtit, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë. Ankesa ushtrohet përmes kësaj Gjykate.